

V E N D I M
Nr.163, datë 31.10.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 22.9.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.150 Akti që i përket:

Kërkues: STEFAN NAUMOV, përfaqësuar nga avokat Halil Kopani.

SUBJEKTE Të INTERESUARA: PRESIDENTI i REPUBLIKËS, përfaqësuar nga Vjollca Uruçi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i dekretit nr.3089, datë 20.9.2001 të Presidentit të Republikës për revokimin e nenit 1 të dekretit nr.1780, datë 17.4.1997 "Për dhënien e shtetësisë shqiptare zotit Stefan Borisov Naumov".

Kërkuesi, për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të dekretit të Presidentit të Republikës, ka parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Dekreti është bazuar në nenin 92 shkronja "c" të Kushtetutës, e cila i jep kompetencë Presidentit të Republikës të japë shtetësinë shqiptare dhe të lejojë lënien e saj, por jo të revokojë një dekret të mëparshëm për dhënie shtetësie.

- Dekreti bie ndesh me nenin 19/2 të Kushtetutës, pasi, sipas kësaj dispozite, shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveç se kur heq dorë prej saj.

- Presidenti i Republikës, përpara se të nxirrte dekretin, duhet të dispononte një vendim gjyqësor të formës së prerë, që të vërtetonte falsitetin e dokumenteve dhe njëkohësisht ekzistencën e veprës penale, siç parashikohet në nenin 186 të Kodit Penal.

- Presidenti i Republikës duhej të kërkonte respektimin e një procesi të rregullt ligjor, duke vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbi të cilin është bazuar për nxjerrjen e dekretit për heqjen e shtetësisë së kërkuesit, si dhe t'i krijonte mundësinë për t'u dëgjuar përpara se të vendoste.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes gjyqtarin Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr.3089, datë 20.9.2001, ka revokuar nenin 1 të dekretit nr. 1780, datë 17.4.1997 për dhënien e shtetësisë shqiptare zotit Stefan Borisov Naumov, me arsyetimin se kërkesa e tij për marrjen e shtetësisë shqiptare është bazuar mbi dokumente të falsifikuara.

Kërkuesi Stefan Naumov, më datën 2.10.2001, pasi është vënë në dijeni të revokimit të

shtetësisë shqiptare, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës si antikushtetues.

Me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, datë 9.10.2001 në shqyrtim paraprak është vendosur kalimi i çështjes në seancë plenare, pasi nga pikëpamja formale kërkesa plotësonte shkakun dhe bazën ligjore për shqyrtim gjyqësor.

Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i kërkuarit ka deklaruar se në datën 4.10.2001, e njëjta kërkesë, me të njëjtët palë dhe me të njëjtin objekt është paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila me vendimin nr.4764 Akti, datë 4.10.2001 ka vendosur moskompetencën e saj për gjykimin e çështjes. Kundër këtij vendimi, kërkuari Stefan Naumov ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit nr.4764, datë 4.10.2001 të gjykatës së shkallës së parë.

Ndodhur në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se çështja nuk mund të zgjidhet përfundimisht nga ana e saj pa përfunduar shqyrtimi i çështjes në hallkat e sistemit të zakonshtëm gjyqësor. Përderisa kërkuari, konform rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë dhe, meqenëse aktualisht çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, është e kuptueshme se ajo Gjykatë duhet detyrimisht t'i japë zgjidhje më parë kësaj çështjeje. Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese, pa shteruar më parë të gjitha mjetet e ankimit, do të përbënte një tejkalim të kuptimit që neni 131 shkronja "f" e Kushtetutës ka parashikuar për juridiksionin kushtetues të kësaj Gjykate, si dhe, njëkohësisht, do të kufizonte të drejtën kushtetuese të individit për t'u paraqitur përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, e caktuar sipas ligjit. Vetëm pasi ankuesi të ketë shteruar të gjitha mjetet e mbrojtjes dhe pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor të mos kenë gjetur zgjidhje, atëherë çështja mund të paraqitet për gjykim përfundimtar në Gjykatën Kushtetuese.

Nisur nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se momentalisht çështja nuk mund të gjykohet nga ana e saj dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet rrëzuar me arsyetimin e mungesës së juridiksionit. Gjithashtu, lidhur me fuqinë e vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se duhet të zbatojë nenin 26 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës, si dhe në nenet 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIM I PAKICËS

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për arsye të devijimit që i bëhet jurisprudencës kushtetuese, lidhur me shqyrtimin e dekretëve të Presidentit të Republikës, si dhe të lënies njëkohësisht të pazgjidhur në vazhdimësi të çështjes së juridiksionit mbi këto akte, gjë që e cila mbart në vetvete rrezikun potencial të një konflikti juridiksional midis gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës Kushtetuese.

Stefan Naumov, me cilësinë e ankuesit, në bazë të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë, nëpërmjet të cilës kërkon shfuqizimin si antikushtetues të dekretit të Presidentit të Republikës, i cili i ka hequr atij shtetësinë shqiptare.

Çështja e shtetësisë në Kushtetutën tonë përfshihet në parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve dhe, duke u konsideruar e tillë, normat e së drejtës ndërkombëtare kanë parashikuar si një detyrim për legjislacionin e çdo shteti, për rastet e cenimit të kësaj të drejte, dhënien e mundësisë ankuesve për të përdorur të gjitha mjetet e mbrojtjes përpara një organi gjyqësor

ose çdo organizimi tjetër të pavarur.

Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", megjithëse parashikon nga njera anë të drejtën e Presidentit të Republikës për të revokuar dhënien e shtetësisë për ata individë që mund ta kenë përfituar këtë të drejtë me dokumente të pasakta apo të falsifikuara, nga ana tjetër nuk ka parashikuar në asnjë nga dispozitat e tij të drejtën e ankimit ndaj rasteve të tilla. Në këto kushte, duke qenë se ligji specifik nuk jep rrugën ligjore të ankimit për këtë problem, atëhere mbetet interpretimi i rregullave të përgjithshme procedurale për goditjen e akteve administrative në gjykatën e zakonshme ose interpretimi i nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës për të përcaktuar organin kompetent për shqyrtimin e akteve të tilla.

Çështja Naumov është paraqitur për shqyrtim, njëkohësisht, në dy gjykata. Nga dokumentacioni që ndodhet në dosje rezulton se në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur kërkesa nga Stefan Naumov me të njëjtët palë dhe objekt në datën 2.10.2001, ndërsa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranë në datën 4.10.2001. Seanca gjyqësore është zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Tiranë po në datën 4.10.2001, ku është vendosur moskompetenca e saj, ndërsa në Gjykatën Kushtetuese në datën 22.10.2001. Ndërkohë që në Gjykatën e Lartë nuk është zhvilluar seanca gjyqësore mbi ankimin e paraqitur nga kërkuesi Naumov.

Në këto rrethana duhej përcaktuar gjykata kompetente që do të vendoste për juridiksionin e kësaj çështjeje.

Në pamje të parë, si Gjykata Kushtetuese, ashtu edhe Gjykata e Lartë kanë të drejtë dhe pavarësisht nga njera-tjetra që të vendosin për juridiksionin e kësaj çështjeje. Megjithatë juridiksionin e gjykatës së zakonshme nuk mund ta vendosë dot Gjykata Kushtetuese, ashtu si juridiksionin kushtetues nuk mund ta vendosë Gjykata e Lartë.

Shumica, me vendimin e saj, duke u shprehur për mungesën e juridiksionit për arsye të mosshterimit të mjeteve juridike në hallkat e tjera gjyqësore, në të njëjtën kohë ka pranuar se kjo çështje hyn në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor. Arsyetimi i shumicës për mosshterim të mjeteve juridike do të vlente nëse ajo do të bindej se gjykata e zakonshme është kompetente për shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dekretit të Presidentit të Republikës. Një kompetencë e tillë ushtrohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese.

Është e vërtetë që sipas nenit 131 shkronjat "a, b, c" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk kryen gjykim abstrakt ndaj akteve administrative individuale. Këtë gjykim ajo e kryen vetëm ndaj ligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe akteve normative të organeve qendrore e vendore. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese shqyrton edhe aktet administrative individuale në rastet e shkarkimit të organeve të pushtetit vendor nga Këshilli i Ministrave (neni 115); në rastet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve (neni 131 shkronja "e"), si dhe në rastet e parashikuara nga neni 131 shkronja "f", kur individëve u shkelen të drejtat e tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pas shterimit të mjeteve juridike.

Rasti i fundit kërkon interpretim kushtetues, të cilin shumica pa të drejtë e ka anashkaluar, duke e lënë problemin të diskutueshëm. Interpretimi i kësaj dispozite kushtetuese, duke e harmonizuar dhe me kuptimin që paraqet neni 326 i Kodit të Procedurës Civile, do të përcaktonte përfundimisht edhe juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për aktet që nxjerr Presidenti i Republikës. Nga interpretimi i nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përjashtojë vetveten, pasi është në funksion të të provuarit të shterimit ose jo të mjeteve të tjera juridike për ankuesin.

Neni 326 shkronja "c" e Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar rastin se nuk mund të bëhet padi në gjykatën e zakonshme për aktet administrative, të cilat janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Shkronja "a" e këtij neni mendoj se i jep zgjidhje definitive kësaj çështjeje. Ajo përmend ato akte për të cilat nuk mund të bëhet padi në gjykatë, duke specifikuar llojin e organit që nxjerr aktin dhe natyrën e aktit. Përmenden si organe Këshilli i Ministrave dhe institucionet e tjera të administratës publike të nivelit qendror dhe vendor, ndërsa si akte ato me karakter normativ. Të gjitha aktet e tjera me natyrë individuale që nxirren vetëm nga këto organe, dhe e theksojmë vetëm nga këto, duhet të goditen në gjykatë. Pra, nuk përmendet si organ Presidenti i Republikës apo aktet e tij, as organet e tjera më të larta si Kuvendi, i cili nuk kufizohet në të drejtën për të nxjerrë akte me natyrë individuale. Në këto kushte, aktet e Presidentit të Republikës, duke mos u përfshirë në shkronjën "a" të nenit 326, është e kuptueshme që do të interpretohen sipas shkronjës "c" të këtij neni.

Pavarësisht nga mendimi që ne kemi për qënien kompetent të Gjykatës Kushtetuese si i vetmi organ që duhet të shqyrtojë pajtueshmërinë kushtetuese të dekreteve me natyrë administrative të

Presidentit të Republikës, zgjidhja më e drejtë për shumicën do të ishte pikërisht mbajtja e një qëndrimi përfundimtar për juridiksionin e çështjeve të tilla.